

Student Workshop 2025

Më 16 janar 2025, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës organizoi aktivitetin “Student Workshop 2025”, me mbështetjen e MetaNow Dev.

Gjatë workshopit, studentët prezantuan punime dhe ide inovative në fusha të ndryshme të teknologjisë, ndër të cilat Inteligjenca Artificiale, teknologjitë e uebit, tregtia elektronike dhe multimedia. Aktiviteti krijoi një hapësirë të vlefshme për prezantimin e projekteve studentore, shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e kreativitetit.

Workshopi u përshëndet nga Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, i cili nënvizoi rëndësinë e inovacionit, krijimtarisë dhe zhvillimit të aftësive praktike të studentëve në fushën e teknologjisë.

Në përfundim të aktivitetit u vlerësuan me çmime tri punimet më të mira studentore. Çmimet shërbyen si një vlerësim për përkushtimin, punën dhe idetë krijuese të studentëve pjesëmarrës.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit falënderon studentët, stafin akademik, drejtuesit e Universitetit dhe sponsorin MetaNow Dev për mbështetjen dhe kontributin në realizimin e aktivitetit.

“Student Workshop 2025” dëshmoi rëndësinë e nxitjes së iniciativave studentore dhe të krijimit të hapësirave ku të rinjtë mund të prezantojnë ide, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të kontribuojnë në të ardhmen e teknologjisë.

Start-up Studentor 2025

Më 13 mars 2025, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës u zhvillua veprimtaria “Start-up Studentor 2025”, një nismë e përbashkët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Fakultetit të Biznesit.

Veprimtaria mbledhi së bashku drejtues të universitetit dhe të dy fakulteteve, përfaqësues të kompanive të njohura të teknologjisë, staf akademik dhe studentë. Në qendër të saj ishin idetë inovative të studentëve dhe mundësitë për zhvillimin e tyre nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe industrisë.

Në fjalët përshëndetëse, Rektori i UAMD-së dhe Dekanët e dy fakulteteve theksuan rëndësinë e lidhjes së njohurive universitare me nevojat e tregut të punës. Ata vlerësuan se nisma të tilla ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike, krijuese dhe sipërmarrëse të studentëve, duke i inkurajuar ata të vijojnë punën për realizimin e ideve të tyre.

Gjatë veprimtarisë, studentët prezantuan projektet dhe zgjidhjet e tyre inovative përpara pjesëmarrësve dhe jurisë së përbërë nga përfaqësues të bizneseve të ftuara. Projektet u vlerësuan për kreativitetin, mënyrën e prezantimit dhe potencialin për zhvillim të mëtejshëm.

Në përfundim, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ndau tri çmime për idetë më të mira, të përzgjedhura nga juria. Vlerësimi synoi të mbështeste përpjekjet e studentëve dhe t'i motivonte ata për ta zhvilluar më tej frymën e sipërmarrjes dhe të inovacionit.

“Start-up Studentor 2025” shënoi një tjetër hap në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe sektorit të biznesit, duke krijuar mundësi konkrete për promovimin e ideve studentore dhe për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës.

Edicioni i tretë i Konferencës Shkencore Studentore të FTI

Më 13 qershor 2025, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, organizoi edicionin e tretë të Konferencës Shkencore Studentore, me nismën e Departamentit të Matematikës.

Konferenca krijoi një hapësirë akademike për prezantimin dhe diskutimin e punimeve të përgatitura nga studentët e programit të studimit Matematikë Informatikë, në nivelet Bachelor dhe Master. Aktiviteti synoi të nxiste angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor, zhvillimin e aftësive të prezantimit dhe shkëmbimin e ideve në fusha që ndërthurin matematikën, teknologjinë dhe arsimin.

Aktiviteti u përshëndet nga Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, i cili theksoi rëndësinë e mbështetjes së brezit të ri dhe rolin e kërkimit shkencor në formimin akademik dhe profesional të studentëve.

Dekania e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Prof. Asoc. Anjeza Pasku, përgëzoi studentët për punën, përkushtimin dhe gatishmërinë për të prezantuar idetë dhe rezultatet e tyre përpara komunitetit akademik.

Përgjegjësjë e Departamentit të Matematikës, Dr. Teuta Thanasi, vlerësoi kontributin e stafit akademik dhe të studentëve në organizimin e aktivitetit, si dhe rëndësinë e zhvillimit të konferencës studentore si një traditë e qëndrueshme akademike e fakultetit.

Punimet dhe prezantimet përfshinë tema nga fusha të ndryshme, ndër të cilat:

- polinomet interpoluese;
- shpërndarjet e veçanta statistikore;
- mësimi i matematikës përmes kodimit dhe programimit;
- përdorimi i teknologjisë në mësimdhënien e matematikës;
- mësimdhënia e matematikës;
- programimi për desktop dhe pajisje mobile;
- teknologjitë web;
- bazat e të dhënave;
- sistemet e informacionit;
- tregtia elektronike;
- rrjetet kompjuterike;
- multimedia dhe fusha të tjera të lidhura me teknologjinë e informacionit.

Punimet u përgatitën nën drejtimin dhe kujdesin akademik të pedagogëve, të cilët i mbështetën studentët gjatë procesit të zhvillimit dhe prezantimit të tyre.

Edicioni i tretë i Konferencës Shkencore Studentore dëshmoi interesin dhe angazhimin e studentëve për kërkimin, teknologjinë dhe zhvillimin e ideve me karakter ndërdisiplinor. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit falenderon studentët pjesëmarrës, stafin akademik, organizatorët dhe të gjithë ata që kontribuan në realizimin e aktivitetit.

International Conference on Computer Science & Information Technology CSIT 2025

Në datat 19 dhe 20 qershor 2025, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zhvilloi Konferencën Ndërkombëtare në Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, CSIT® 2025.

Konferenca u hap me një ceremoni të veçantë në mjediset e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, me pjesëmarrjen e Rektorit, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, Dekanes së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Prof. As. Dr. Anjeza Pasku, dekanëve dhe përfaqësuesve të universiteteve partnere nga rajoni, përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave, studiuesve, akademikëve, profesionistëve dhe folësve të ftuar ndërkombëtarë.

Gjatë ceremonisë së hapjes u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, shkëmbimit të njohurive dhe avancimit të kërkimit shkencor në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit.

Përgjatë dy ditëve të konferencës, pjesëmarrësit prezantuan dhe diskutuan gjetjet më të fundit shkencore, zhvillimet teknologjike dhe qasjet bashkëkohore në fusha të tilla si:

- Inteligjenca Artificiale
- Machine Learning
- Teknologjitë emergjente
- Siguria kibernetike
- Zhvillimi i softuerit
- Internet of Things, IoT
- Cloud Computing
- Shkencat kompjuterike dhe teknologjia e informacionit

CSIT® 2025 krijoi një hapësirë të rëndësishme për prezantimin e rezultateve kërkimore, shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e sfidave dhe mundësive që lidhen me zhvillimin e teknologjisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Konferenca kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve, institucioneve kërkimore dhe profesionistëve të fushës, si dhe në nxitjen e krijimit të lidhjeve të reja akademike dhe shkencore.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit falenderon të gjithë pjesëmarrësit, folësit e ftuar, studiuesit, akademikët, bashkëpunëtorët dhe kontribuesit që ndihmuan në realizimin me sukses të CSIT® 2025.